

VENDIM
Nr. 198, datë 6.3.2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1 dhe 23 pika 3 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “A” “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët” shtohen individët e renditur në shkronjën “a” të listës “Lista e shtuar e individëve në listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

2. Nga lista e shkronjës “A” “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët” çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “b” të listës “Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si individë të çregjistruar nga anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

3. Në fund të shkronjës “B” “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët” shtohen kompanitë e renditura në shkronjën “c” të listës “Lista e shtuar e kompanive në listën e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si bashkëpunëtorë ose financues për talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë që janë bashkëpunëtoresh apo financuese për talibanët.

4. Nga lista e shkronjës “C” “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “d” të listës “Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si persona të çregjistruar nga anëtarë bashkëpunëtorë apo financues për Al-Qaida me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

5. Në fund të shkronjës “D” “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, shtohen kompanitë e renditura në shkronjën “e” të listës “Lista e shtuar e kompanive në listën e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si bashkëpunëtorë ose financues për organizatën Al-Qaida, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë që janë bashkëpunëtoresh ose financuese për organizatën Al-Qaida.

6. Nga lista e shkronjës “D” “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen kompanitë e renditura në shkronjën “f” të listës “Lista e kompanive të çregjistruara nga lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si kompani të çregjistruara me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

a) Lista e shtuar e individëve në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”:

1. MOHAMMED QASIM: SADOZAI: KHUDAI RAHIM

b) Lista e individëve të çregjistruar nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”.

1. ABDUL RAZAQ: EKHTIYAR MOHAMMAD;
2. ZABIHULLAH: ZAHID: ABDUL MAJID;
3. ABDUL WAHAB: ABDUL GHAFAR.

c) Lista e shtuar e kompanive në “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”:

1. RAHAT LTD.

d) Lista e individëve të çregjistruar nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”:

1. IBRAHIM: BEN HEDHILI: BEN MOHAMED: AL-HAMAMI;
2. HABIB: BEN ALI: BEN SAID: AL-WADHANI;
3. SULAYMAN: KHALID: DARWISH;
4. SUHAYL: FATILLOEVICH: BURANOV;
5. NAJMIDDIN: KAMOLITDINOVICH: JALOLOV;
6. MADHAT: MURSI: AL-SAYYID: UMAR;
7. ADEL: ABDULJALIL: IBRAHIM: BATTERJEE.

e) Lista e shtuar e kompanive në “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”:

1. Mouvement pour l’Unification et le Jihad en Afrique de l’Ouest (MUJAO).

f) Lista e kompanive të çregjistruara nga “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”:

1. AL-HAMATI SWEETS BAKERIES;
2. BENEVOLENCE INTERNATIONAL FUND;
3. BOSANSKA IDEALNA FUTURA;
4. HEYATUL ULYA;
5. RED SEA BARAKAT COMPANY LIMITED;
6. SOMALI INTERNET COMPANY.